



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MALLAKASTËR**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 2030 Prot.

Ballsh më, 27 . 04 .2023

**VENDIM**

Nr. 20 Datë 26 . 04 /2023

**PËR**

**MIRATIMIN E PAGESËS SË DEPOZITIMIT TË MBETJEVE TË BASHKISË  
MALLAKASTËR NË LANDFILL**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen Vendore”, VKB nr. 52, datë 28.09.2022 “Për dhënien e autorizimit Kryetarit të Bashkisë Mallakastër për fillimin e procedurave të negociimit me bashkitë e Qarkut Fier për realizimin e procedurave të marrjes në dorëzim sipas detyrimeve të kontratës “Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier”, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër”, Marrëveshjes për krijimin e e subjektit të përbashkët të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier (protokolluar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 5618 Prot., datë 14.11.2022) shkresës me Nr 76 Prot datë 15.03.2023 të Integrated Technology Ëaste Treatment Fier sh.p.k. “Mbi fillimin e zbatimit të çmimit për ton të mbetjeve urbane depozituara në landfill nga Bashkitë e Qarkut Fier”, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 1308 Prot., datë 17.03.2023,

**VENDOSI**

1. Miratimin e pagesës së depozitimit të mbetjeve të Bashkisë Fier në Landfill, pranë Inceneratorit Fier, në masën 1400 lekë/ton mbetje të depozituar.
2. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Mallakastër për nënshkrimin e akt – marrëveshjes respektive me subjektin Integrated Technology Ëaste Treatment Fier sh.p.k.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Fitim Baraj**

